



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 387/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi Kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga kandidati për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Elmi Reçica nga koalicioni PDK-AAK- NISMA, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 01.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Elmi Reçica nga koalicioni PDK-AAK-NISMA

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 30.06.2017 në ora 12:10, ka pranuar një ankesë nga Elmi Reçica kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni PDK-AAK- NISMA, në të cilën pretendon se është bërë padrejtësi në qendrën e votimit 0409D/04R pasi që siç thekson ai tradicionalisht ka pasur 28 vota nga zgjedhjet paraprake të vitit 2014 por tash për çudi ka vetëm 7 vota prandaj i njëjti konsideron se gjatë procesit të numërimit dhe regjistrimit të votave është bërë gabim teknik ose nuk janë regjistruar votat e votuesve besnik të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet e parashtruara në ankesës se në vitin 2014 i ka pasur 28 vota në vendvotimin e ankimuar, ndërsa në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare i posedon 7 vota nuk paraqet bazë ligjore për parregullsi dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favore të ankuesit .

Paneli vlerëso se pretendimet në ankesë nuk janë të bazuara dhe nuk i plotëson standardet ligjore si dhe kërkesat e nenit 117 të LZP-së.

PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pa argumentuar me fakte dhe si e tillë e pabazuar .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.387/2017 më datën 01.07.2017



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*